



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-082

Prishtinë, më 5 nëntor 2012, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 5 NËTOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit; Sabri Hamiti, Glauk Konjufca dhe Petar Miletqi, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq dhe Myfera Shinik.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Skender Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca;

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe tri pika shtesë.

Kryesia, me propozimin e Kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 29 tetor 2012,
2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave.

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 tetor 2012

Kryesia e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 29 tetor 2012.

2. Përgatitjet për mbledhjen plenare të radhës:

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 8 nëntor 2012, me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për investimet e huaja,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Avokaturën Shtetërore,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë e Regjistrimit Civil,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për organet qeveritare për shoqërinë e informacionit,
8. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Auditimit për vitin 2011,
9. Ratifikimi i Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës për themelimin e Universitetit të Prizrenit dhe të Universitetit të Pejës,
10. Shqyrtimi i Propozim-vendimit të Ministrisë së Drejtësisë për formimin e Komisionit për dhënien e provimit të Jurisprudencës,
11. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion lidhur me emërimin e anëtarëve të Këshillit për Ndihmë Juridike Falas.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe kërkesave:

1. Procedimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, vendosi që atë ta radhisë në rend të dite të mbledhjes tjetër plenare.

2. Procedimi i Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me procedimin e Projektligjit për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Buxhet dhe Financa, si Komision FunkSIONAL, që ta shqyrtojë Projektligjin për ratifikimin e Marrëveshjes për bashkëpunim financiar ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë dhe Kuvendit t'ia paraqesë Raportin.

3. Kërkesa e Komisionit të Pavarur për Media për kompensimin e anëtarëve të KPM-së

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me rekomandimin e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për kompensimin e anëtarëve të KPM-së, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

1. Bazuar në Ligjin nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Medieve, niveli i kompensimit të pagave për kryetarin dhe anëtarët e Komisionit të Pavarur për Media është paraparë të caktohet me Ligjin për pagat e zyrtarëve të lartë, i cili akoma nuk është miratuar.

2. Komisioni për Buxhet dhe Financa, me rastin e shqyrtimit të Projektligjit për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2013, do ta shqyrtojë kërkesën e Komisionit të Pavarur për Media për përcaktimin e nivelit të pagave për anëtarët e KPM-së dhe Kuvendit do t'ia paraqesë rekomandimin.

4. *Kërkesa e deputetit Ramë Vataj, mbështetur edhe nga tetëmbëdhjetë deputetë të tjerë, për debat parlamentar lidhur me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e deputetit Ramë Vataj, në mbështetje të deputetëve të tjerë, për debat parlamentar lidhur me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Ngarkohet Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media dhe Komisioni për Legjislacion që ta shqyrtojnë bazueshmërinë e rekomandimit, sipas kërkesës së deputetit Ramë Vataj, në mbështetje të deputetëve të tjerë për debat parlamentar lidhur me Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe Kuvendit t'ia paraqesë raportin.

5. *Njoftimi i Grupit Parlamentar të SLS-së lidhur me vendimin për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor*

Kryesia e radhiti propozimin e grupeve parlamentare për zëvendësimin e anëtarëve të komisioneve parlamentare në rend dite të mbledhjes plenare më 5 nëntor 2012.

6. *Njoftimi i Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me vizitën e realizuar në Kroaci*

Kryesia u njoftua me vizitën e Komisionit për Buxhet dhe Financa, të realizuar në Kroaci, prej datës 15-17 tetor 2012.

7. *Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar të deputetëve në Francë*

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit të Kosovës: Hydajet Hyseni dhe Teuta Sahtqija për të marrë pjesë në takimin e Këshillit të Evropës, me temën: “Situata në Kosovë dhe roli i Këshillit të Evropës”, që do të mbahet në Francë, prej 13-15 nëntor 2012.
2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi për të lartshënuarit në paragrafin një (1) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

8. Kërkesa e Nën-komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore e Kuvendit për vizitë pune në Parlamentin e Republikës së Kroacisë

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Nën-komisionit për Mandate, Imunitete e Rregullore të Kuvendit: Armend Zemaj, Albulena Haxhiu, Jasmina Zhivković dhe Gëzim Kelmendi, si dhe Ismet Krasniqi, sekretar i Kuvendit, dhe Advije Morina, staf mbështetës i Komisionit për vizitë pune në Parlamentin e Republikës së Kroacisë, prej 12-13 nëntor 2012.

2. Të gjitha shpenzimet e këtij udhëtimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

9. Propozimi i Grupi Parlamentar të KKR-së për zëvendësimin e anëtarëve në komisionet parlamentare

Kryesia e radhiti propozimin e lartshënuar për mbledhjen plenare më 5 nëntor 2012.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 10:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale